

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Kryesues Altin Abdiu

Anëtar Artan Gjermëni

Anëtar Kreshnik Omari

asistuar nga sekretare gjyqësore Marjana Xhamallati, me date 27.06.2013, përfundoi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çështjen penale që u përket :

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori Julian Zonja.

I pandehur : **P.G**, i biri i C., i dtl(.....), banues ne (.....), me adrese (.....), shtetesi Italiane, pa mase sigurimi, ne mungese, i perfaqesuar me prokurë të posaçme nga avokatët Ferdinand Doja dhe Kloida Dashi.

Akuzuar : Për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose i veprimtarise kriminale”, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, germa “b” i K.Penal.

Në konkluzionet përfundimtare prokurori kërkoi :

1. Deklarimin fajtor të pandehurit P.G, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose i veprimtarise kriminale”, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, germa “b” i K.Penal, dënimin e tij me 6 (gjashtë) vjet burgim dhe 1 000 000 (një milion) lekë gjobë.
2. Mbi masën e dënimit të aplikohen kerkesat e nenit 406 K.Pr.Penale, duke i ulur te pandehurit 1/3 e denimit.
3. Shpenzimet proceduriale ne ngarkim te pandehurit.

-Perfaqesuesja e te pandehurit Av.Kloida Dashi, kerkoi deklarimin e pafajshem te pandehurit P.G, per vepren penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose i veprimtarise kriminale”,

ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, germa “b” i K.Penal, dhe heqjen e sekuestros preventive per shumen e sekuestruar dhe kthimin e saj shtetasit te cilit i perket.

-I pandehuri P.G, ne mungese.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

VEREN

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka paraqitur për gjykim çështjen penale ndaj shtetasve Italian, të pandehurve A.L dhe P.G, te akuzuar per kryerjen e vepres penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose i veprimtarise kriminale”, ne bashkepunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, germa “b” i K.Penal.

Per te pandehurin P.G, konform nenit 352 te K.Pr.Penale, gjykimi eshte zhvilluar ne mungese duke u perfaqesuar nga avokatet e zgjedhur me prokure te posaçme Ferdinand Doja ose Kloida Dashi. Ndersa per te pandehurin tjetër A.L, nga aktet e fashikullit hetimor ka rezultuar se hetimet paraprake jane kryer ne mungese të tij, duke i caktuar nje mbrojtës kryesisht.

Ne gjykim, njoftimi per te pandehurin A.L ne dy adresat e paraqitura nga prokurori, fillimisht ne adresen e kerkeses per gjykim: (.....) dhe ne adresen tjetër të paraqitur në gjykim,(.....), bazuar ne nenin 142 te K.Pr.Penale, eshte kryer me Letër rekomnade me lajmerim marrje. Megjithese jane perseritur disa here njoftimet sipas adresave te mesiperme, ka rezultuar se nuk eshte bere e mundur gjetja dhe njoftimi i ketij te pandehuri.

Ne seancen gjyqesore te dates 24.12.2013, meqenese nga aktet e fashikullit hetimor dhe nga kerkesa per gjykim, prokurori nuk ka paraqitur gjeneralitetet e plota (atesia, mëmësia) për të pandehurin A.L, Gjykata bazuar ne nenin 331 te K.Pr.Penale, i ka caktuar prokurorit si detyre që të plotesojë gjeneralitetet e plota në kërkesën për gjykim (atesine, mëmësinë) për të pandehurin e mësiperm. Por megjithëse procesi gjyqësor është shtyrë disa seanca me radhë për rreth tre muaj, nga ana e prokurorit nuk është zbatuar detyra e caktuar nga gjykata.

Ne keto kushte, ne seancen gjyqesore te dates 27.03.2013, nga perfaqesuesi i te pandehurit P.G, Av. Ferdinand Doja eshte kerkuar ndarja e ceshtjes dhe me pas zhvillimi i gjykimit te shkurtuar.

Gjykata, ka çmuar se në rastin konkret nuk demtohet vertetimi i fakteve, dhe se ceshtja per te pandehurit P.G, zgjidhet ne gjendjen qe jane aktet. Ne keto kushte, bazuar ne nenet 93/1-b, 404 te K.Pr.Penale dhe ne Vendimin Unifikues te Gjykates se Larte Nr.2 date 29.01.2003, ka vendosur, ndarjen e ceshtjes per te pandehurin P.G, për të cilin është zhvilluar gjykimi i shkurtuar, si dhe është veçuar ceshtja për të pandehurin A.L.

Në gjykimin e shkurtuar te ceshtjes ndaj te pandehurit P.G, e cila është në juridiksionin dhe kompetencën e kësaj Gjykate, ne konkluzionet perfundimtare prokurori ka arsyetyuar se:

I pandehuri P.G në bashkëpunim me të pandehurin A.L, kane kryer fshehjen ose mbulimin e natyrës së vërtetë e burimit, të pasurisë produkt i veprës ose i veprave penale” veprim i cili parashikohet nga ligji shqiptar si vepër penale dhe konkretisht “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, gërma b) i K.Penal, per sa më poshtë.

1. I pandehuri për të cilin u veçua ceshtja, A.L,shtetas italian, në datat 04 dhe 05.03.2010 ka kryer dy transferta drejt Shqipërisë nga Sllovenia,në total shumën prej 500.000 euro, e cila është sekuestruar menjëherë pas regjistrimit dhe fillimit të hetimeve për këtë ceshtje penale.

Sipas deklarimeve të bëra prej tij në bankën sllovene, në momentin e transfertave, kjo shumë parash vinte nga *“shitja e një zinxhiri dyqanesh ushqimore në Gjermani”*, që do të thotë në këtë moment një burim i deklaruar i ligjshëm. Përfitues i këtyre transfertave në Bankën “Veneto” në Shqipëri ishte Shoqëria “.....” SPA, pronë e shtetasve italianë G.C, R. dhe R.C. Dega e kësaj shoqërie në Shqipëri është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) në datën 01.06.2009, me numër (.....), me objekt të veprimtarise “punime ndërtimi për vepra civile, aktivitet guroreje, tregëtimi me shumicë i materialeve të ndertimit, ndërtimi dhe tregëtimi i pasurive të paluajtshme për banim ose jo, etj.

Pas kryerjes së këtyre transfertave, në datën 12.03.2010 shoqëria “.....” SPA ka transferuar Brenda bankës “Veneto” shumën 490.000 euro në drejtim të Shoqërisë “.....” SRL me përshkrim “*kthim fondi për moskryerje investimi*”. Shoqëria “.....” SRL është një shoqëri italiane e cila nuk është e regjistruar në Q.K.R. Më pas, nga data 19.03.2010 deri në 29.03.2010 nga numri i llogarisë së shoqërisë “.....” SRL janë bërë tre tërheqje “cash” nga i pandehuri P.G, shtetas italian, konkretisht, në datën 19.3.2010 shuma 10.000 euro, në datën 23.3.2010 shuma 30.000 euro dhe në datën 29.3.2010 shuma 20.000 euro, në total 60.000 Euro. I pandehuri P.G shumën prej 427.000 Euro të ngeluara në llogari ka kërkuar ta transferojë në Itali, në llogarinë e shoqërisë së tij atje, apo në llogarinë e një shoqërie tjetër italiane atje “.....” SRL. Duke qënë se sipas tij, këto fonde do të transferoheshin me qëllim hapjen e një filiali të shoqërisë në Shqipëri, u pa nga banka si e pa bazë, si dhe duke munguar dokumentacioni justifikues për transferimin e kësaj shume, bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë, Banka “Veneto” nuk e kreu transfertën. Pas refuzimit të transfertës nga ana e Bankës Veneto, P.G është regjistruar si person fizik në QKR në datën 07.04.2010 me fushe veprimtarie “tregëti me pakicë të veshjeve” dhe ka hapur një llogari në bankën Intesa San Paolo e me pas i ka kërkuar serish bankes “Veneto” transferimin e parave në llogarinë e re në bankën Intesa Sanpaolo. I pandehuri P.G është përpjekur vazhdimisht me anë të telefonit të kryejë transfertën e shumës prej 427.000 euro nga llogaria e tij në Bankën “Veneto” në llogarinë e tij në bankën Intesa San Paolo. Komunikimi është kryer me anë të telefonit, pasi ai ka deklaruar se ndodhej në Itali gjatë atyre ditëve. Banka serish ka refuzuar të kryejë transaksionin dhe i ka kërkuar P.Gt të sjellë dokumentacionin e duhur për kryerjen e transfertës. Në datën 13.04.2010, P.G ka dërguar me anë të faksit disa dokumenta në bankën “Veneto”, për të vërtetuar burimin e fondeve që kërkonte të transferonte. I pandehuri P.G ka pretenduar se këto dokumenta janë dërguar me faks nga Italia, ndërkohë që në këto dokumenta është bërë i padukshëm numri i faksit nga i cili janë dërguar. Dokumentat e dërguara me faks janë, kopje e një kontrate për investim në pasuritë e paluajtshme, kopje e një marrëveshje midis palëve, kopje e zgjidhjes së kontratës mes palëve dhe shkresë përcjellëse nga P.G.

Sipas kopjes së kontratës të paraqitur, të nënshkruar në datën 25.02.2010, Srl e përfaqësuar nga A.L, do të investonte në Shqipëri. Duke qënë se (.....)ka tashmë një aktivitet të regjistruar në vendin tonë,(.....) Srl i ka kërkuar kësaj të fundit të hartojë një

projekt investimi për të dhe t`ia paraqesë brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës. Shuma e paguar si paradhënie për këtë projekt do të jetë pikerisht 500.000 euro dhe (.....) duhet ta kthejë këtë shumë tek (.....) - SRL, duke hequr vetëm shpenzimet e kryera, brenda 10 ditëve nga nënshkrimi i kontratës nese projekti nuk realizohet. Bashkëlidhur kontratës është edhe marrëveshja mes palëve për investim, e cila shpreh të njëjtën ide si kontrata. Në këtë dokument përshkruhet në detaje se si do të kryhet transaksioni midis palëve, duke lënë mënjanë faktin se si A.L do të transferonte fondet tek (.....). Dokumenti i zgjidhjes së kontratës shpreh po të njëjtat fakte të përshkruara në kontrate dhe shpjegon shumat e sakta të fondeve që do të transferohen nga (.....)tek (.....)- SRL, duke mos parashikuar për asnjë moment, qoftë edhe kostot monetare të një transaksioni kaq të madh me anë të kanaleve bankare.

Referuar dokumentacionit të mësipërm rezulton se shuma e sekuestruar është transferuar nga i pandehuri A.L, ndërkohë që nga të gjitha aktet nuk rezulton që A.L të ketë lidhje me shoqërinë “(.....)” SRL. E vetjma e dhënë sipas dokumentacionit të dërguar tek Banka “Veneto” nga P.G, është ajo në marrëveshjen e datës 01.03.2010 lidhur në Fossombrone, Itali, ku i pandehuri P.G ka nënshkruar si i autorizuar nga A.L, por, në fakt, nuk ka asnjë akt që ta tregojë këtë. Kjo marrëveshje është zgjidhur në datën 12.03.2010 me anë të një deklaratë të nënshkruar në Tiranë nga P.G dhe G.C. Nga verifikimi në sistemin TIMS rezulton se G.C është larguar nga Shqipëria në datën 06.03.2010 dhe ka hyrë përsëri në datën 29.03.2010, pra në datën 12.03.2010 kur rezulton se ka nënshkruar këtë deklaratë nuk ka qënë në Shqipëri. Po kështu, dokumentacioni i depozituar nga “(.....)” tek Banka “Veneto” për transferimin e shumës 490.000 euro në datën 12.03.2010 është tërësisht i ndryshëm nga i njëjti dokumentacion i depozituar nga P.G për tërheqjen e shumës. Aktmarrëveshja midis “.....” SRL dhe “(.....)” SPA, këtu është e datës 05.03.2010 dhe ndryshon në përmbajtje dhe formatin e shkrimit. Në përmbajtje bëhet fjalë për ndërtimin e një reparti të Klinikës “Villa Giose” në Itali nga “(.....)” me fonde të mbledhura nga “.....” SRL në shumën 500.000 euro, ndërsa në marrëveshjen e datës 01.03.2010 depozituar nga P.G bëhet fjale për studimin e tregut dhe një projekt investimi për hapjen e degës së “.....” SRL në Shqipëri. Përveç kësaj, në datën e kësaj marrëveshje të lidhur më 05.03.2010 në Fossombrone, Itali, shtetasi G.C që rezulton se ka firmosur në marreveshje ka qënë në Shqipëri nga data 04.03.2010 deri në datën 06.03.2010.

Në një dokument tjetër, Kontratë shërbimi e datës 15.4.2010 (pas sekuestrimit të shumës) midis “.....” SRL dhe P.Gt nënshkruar në Tiranë, shoqëria “.....” SRL (nuk dihet se nga kush është firmosur për “.....” SRL) do ti paguajë P.Gt një shumë paradhënie prej 426.900 euro (shuma e mbetur në bankën Veneto pas tërheqjeve të P.Gt) për shërbimet që ky do të kryejë si kontrollues i cilësisë së produkteve në Shqipëri, etj.

Në të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga P.G nuk përmendet qoftë edhe një here fakti se shuma prej 500.000 euro është transferuar nga Sllovenia nga A.L, i cili ka deklaruar në bankën nisëse se, burimi i të ardhurave është *“shitja e një zinxhiri dyqanesh ushqimi në Gjermani”*. Gjithashtu, vihet re se i gjithë dokumentacioni i paraqitur nuk është i hartuar ose cert.....ikuar pranë një noteri, por janë thjesht deklarata midis palëve, llogaria bankare e “.....” SRL pranë bankës “Veneto” është hapur në datën 12.03.2010, kur dhe është transferuar shuma dhe dokumentacioni i zgjidhjes së marrëveshjes midis palëve për të justifikuar transferimin e shumës mban po këtë datë. Duke parë justifikime të ndryshme të shumës së sekuestruar rezulton se ky dokumentacion është fiktiv, sa për të mbuluar lëvizjen e shumës në transaksionet bankare.

2. I pandehuri P.G, njihet nga autoritetet ligj zbatuese italiane si person me aktivitet kriminal, në datën 25.01.1996 për falsifikime të ndryshme, në datën 23.01.2004 për vjedhje të një furgoni, në datën 21.05.2007 për kërcënim, në 06.06.2009 për mashtrim si përfaqësues ligjor i shoqërisë “(.....)” Srl. Italia (në Marotta di Fano, Itali), pasi me anë të mashtrimeve ka mundur të mos paguajë detyrimet që kishte ndaj shoqërisë “(.....)” Srl dhe në datën 08.09.2009 për tentativë mashtrimi. Në vitet 2007-2008, P.G ka grumbulluar një shumë prej 266.106 euro dhe 257.694 euro nga një vetpunësim i pa deklaruar tek një kompani me qendër në Rumani, e cila e ka mbyllur aktivitetin në datën 17.11.2008. Gjithashtu, përfaqësuesit e kompanisë “(.....)”, G.C dhe R.C, njihen nga autoritetet italiane si persona me aktivitet kriminal për veprat penale të thyerjes së ligjit për tenderat dhe mashtrim.

3. Në ekzekutim të letërporosisë, autoritetet gjermane kanë informuar se për asnjë nga shtetasit e përmendur më sipër dhe në vecanti për të pandehurin A.L nuk ka informacion në Gjermani. Nga përgjigja e autoriteteve gjyqësore gjermane rezulton se burimi i të ardhurave të transferuara nuk është ai i deklaruar nga A.L, *“nga shitja e një zinxhiri dyqanesh në Gjermani”*.

Nga sa më sipër, sipas prokurorit shihet se efektivisht paratë nga A.L kanë patur destinacion të pandehur P.G dhe versioni i deklaruar në prokurori nga ky i fundit, nuk ka asgjë të përbashkët me versionin e tij në bankë dhe secili prej tyre nuk argumenton qëllimin ligjor e ekonomik të transaksioneve të kryera. Sipas versionit të bankës, A.L në emër të “.....” Srl ka dërguar para tek (.....), si paradhënie për një kontratë për hartim projekti investimesh. Sipas versionit të dhënë në prokurori, kjo shumë e kaluar nga A.L nuk ka patur atë qëllim, por ka pasur si qëllim plotësimin e kushtit për marrjen e një kredie nga (.....), e cila do të kthente shumën e transferuar plus 250.000 euro të tjera. Nga ana tjetër edhe shtetasit italianë (.....) nuk janë paraqitur të japin shpjegime rreth marrëdhënies së tyre me bankën dhe të pandehurit, pasi që nga data 19.05.2011 janë larguar jashtë shtetit.

Sipas prokurorit, nga transaksionet e kryera, rezulton se destinacioni i vërtetë i fondeve të transferuara nga A.L nga Sllovenia ka qënë P.G dhe shoqëria “.....” SRL, me qëllim për ti futur ato sërish në Itali, dhe për të humbur gjurmët e transfertës e për të evituar zbulimin e burimit të vërtetë të fondeve, si dhe destinacionit të tyre, është përdorur shoqëria “(.....)”. Duke pasur parasysh faktin se P.G është person me veprimtari kriminale, sidomos në fushën financiare, duke siguruar shuma të konsiderueshme monetare nga kjo veprimtari kriminale, faktin se burimi i të ardhurave provohet se nuk është ai i deklaruar nga A.L, rezulton që shuma objekt transaksionesh të jetë produkt i veprimtarisë kriminale dhe veprave penale të kryera nga i pandehuri. Pra nga veprimet e kryera prej të pandehurit P.G, rezulton dijenia e tij se kjo shumë është produkt i veprimtarive kriminale dhe i veprave penale për të cilat është dënuar A.L dhe qëllimi i tyre, për fshehjen e origjinës së këtyre fondeve, nepërmjet transferimit të tyre në Shqipëri e më pas përsëri jashtë shtetit.

Në këto rrethana, duke qënë se provohet jo vetëm veprimtaria kriminale, por edhe veprat penale për të cilat është dënuar transferuesi i shumës, përfitimi i paligjshëm i siguruar prej këtyre veprave penale, mos justifikimi i origjinës së shumës, provohet lidhja dhe prejardhja e saj nga veprat penale. Për këto arsye, veprimet e të pandehurit P.G përbëjnë elementë të veprës penale të “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, në bashkëpunim, parashikuar nga neni 287, parag.2, germa b) i K.Penal.

Pala mbrojtese kundërshtoi akuzën e ngritur nga prokuroria, ajo kerkoi deklarimin e pafajshëm të pandehurit P.G dhe heqjen e sekuestros preventive për shumën e sekuestruar,

me arsyetimin se organi i akuzes nuk provoi kryerjen e ndonje vepre penale qe te kete qene shkak i perfitimeve te paligjshme dhe i pastrimit te produkteve qe rrjedhin nga nje krim, nga ana e te pandehurit.

Gjykata vëren se, në nenin 287 paragrafi 2 germa “b” te K. Penal, me titull “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale*”, për të cilin akuzohet i pandehuri P.G, është parashikuar se:

“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet :

b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale... ”.

Që të ekzistojë ana objektive e figurës së kësaj vepre penale, duhet të provohet ekzistenca e një vendimi penal të formës së prerë, i cili vërteton kryerjen e veprës penale, ose një veprimtari kriminale, të cilat kanë prodhuar një produkt (pasuri) kriminale, dhe më pas lidhja e këtij produkti (shumës) me veprën penale për të cilën akuzohet aktualisht i pandehuri P.G.

Për të provuar këtë element të kësaj vepre penale, organi i prokurorisë sipas arsyetimit të mësipërm, rezulton se është bazuar vetëm me dyshime, të dhëna të pergjithëshme se i pandehuri P.G njihet nga autoritetet Italiane si person me aktivitet kriminal për fals.....ikime,vjedhje,kercënime, mashtrime.

Rrethanat e mësipërme të paraqitura nga prokurori ne kuptim të neneve 149 e vijues dhe kreut II me titull “*Llojet e provave*” te K.Pr.Penale,nuk përbëjnë prova, por dyshime se i pandehuri ka kryer veprën për të cilën akuzohet.

Keto dyshime në bazë të nenit 4 të K.Pr.Penale, shkojnë në favor të të pandehurit.

Megjithëse ky procedim ka filluar që në datën 16.04.2010, në aktet e fashikullit hetimor, i cili u kthye ne fashikull gjyqësor, për shkak të zhvillimit të gjykimit të shkurtuar, gjykim për të cilin ishte dakort dhe prokurori, (i cili pohoi ne kërkesat paraprake se kjo çështje mund te zgjidhej ne gjendjen që janë aktet), nuk ekziston një vendim penal i formës

së prerë, i cili do të provonte kryerjen e veprës penale dhe ekzistencën e produktit kriminal të rrjedhur prej saj.

Ne nenin 388 të K.Pr.Penale , me titull “Vendimi i pafajësisë” ndër të tjera është parashikuar se:

A) Gjykata merr vendim pafajësie kur :

I. *“Fakti nuk ekziston, ose nuk provohet se ekziston. . . ”*

Në këto kushte, Gjykata bazuar në nenin 388/1-a të K.Pr.Penale, çmon se i pandehuri P.G, duhet të deklarohet i pafajshëm për akuzën e ngritur nga prokuroria, sepse fakti i paraqitur nga prokuroria nuk u provua se ekziston.

Ne kuadër të këtij procedimi, që në hetimet paraprake me vendimin Nr.1633 Akti të dtës 02.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur venia e sekuestros preventive mbi llogarinë bankare në euro të Shoqërisë “.....-SRL” në Bankën “Veneto” Nr.00012350.

Meqënëse i pandehuri P.G, rezultoi i pafajshëm për akuzën e kryerjes së veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale, ose i veprimtarisë kriminale”, bazuar në nenin 275/1 të K.Pr.Penale, Gjykata çmon se duhet vendosur heqja e Sekuestros Preventive mbi llogaritë bankare në euro të Shoqërisë “..... – SRL” në Bankën “Veneto” me Nr.(.....) të dhënë me vendimin Nr.1633 Akti, datë 02.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sepse fakti penal nuk u provua se ekziston.

PER KETO ARSYE

Gjykata në zbatim dhe të neneve 379 - 384 të K.Pr.Penale.

VENDOSI

4. Deklarimin e pafajshëm të pandehurit **P.C.G**, për kryerjen e veprës penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, në bashkepunim, parashikuar nga neni 287, paragrafi 2, germa “b” i K.Penal.
5. Heqjen e Sekuestros Preventive mbi llogaritë bankare në euro të Shoqërisë “..... – SRL” në Bankën “Veneto” me Nr.(.....) të dhënë me vendimin Nr.1633 Akti, datë 02.11.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Shpenzimet procedurale siç janë bërë.
7. Kundër vendimit lejohet ankim brenda 10 ditësh nga e nesërmeja e shpalljes në Gjykatën e Apelit Tiranë.
8. U shpall në Tiranë, më datë 27.06.2013.

S E K R E T A R E

MARJANA XHAMALLATI

G J Y Q T A R

ALTIN ABDIU